UDHËZIM
Nr. 10, datë 4.11.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË ARDHUR NGA ADMINISTRATA TATIMORE, VERIFIKIMIT ME POLICINË E SHTETIT, VLERËSIMIT TË DËMIT NGA EKSPERTË TË LICENCUAR, SI DHE KRYERJES SË PAGESËS SË KOMPENSIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 4, pika 5, të aktit normativ nr. 6, datë 28.10.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e dëmit civil të shkaktuar ndaj subjekteve të prekura nga aktet e dhunshme gjatë tubimeve dhe rregullimin e pasojave",

UDHËZOJ:

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim përcakton procedurat për shqyrtimin e kërkesave për kompensimin e dëmeve materiale mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të subjekteve të përcaktuara në aktin normativ nr. 6, datë 28.10.2026, "Për shpërblimin e dëmit civil të shkaktuar ndaj subjekteve të prekura nga aktet e dhunshme gjatë tubimeve dhe rregullimin e pasojave", duke përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga administrata tatimore, verifikimin të shkaktimit të dëmit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, vlerësimin e dëmit nëpërmjet ekspertëve të licencuar, procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për pranimin ose refuzimin e kërkesës, si dhe mënyrën e kryerjes së pagesës së kompensimit në favor të subjekteve përfituese.

Neni 2
Administrimi i praktikës

1. Kërkesat e përcjella nga administrata tatimore regjistrohen në protokollin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe i kalojnë për shqyrtim strukturës përgjegjëse për nxitjen e biznesit dhe zhvillimin ekonomik në vijim "struktura përgjegjëse".
2. Struktura përgjegjëse regjistron praktikën e përcjellë nga administrata tatimore, duke evidentuar datën e marrjes, të dhënat identifikuese të kërkuesit dhe dokumentet shoqëruese. Për këtë qëllim mban një regjistër të posaçëm.
3. Për çdo kërkesë krijohet një dosje, në formë shkresore dhe/ose elektronike, në të cilën administrohen dokumentacioni i kërkuesit, të dhënat e dërguara nga

administrata tatimore, korrespondenca ndërinstitucionale, akti i ekspertimit, vendimmarrja dhe dokumentet e pagesës.

Neni 3

Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të dërguar nga administrata tatimore

1. Struktura përgjegjëse shqyrton dokumentacionin dhe të dhënat e përcjella nga administrata tatimore, të cilat duhet të përmbajnë të dhënat për regjistrimin, qarkullimin e deklaruar në deklaratën vjetore, faturat tatimore dhe inventarin e deklaruar. Nga të dhënat e përcjella duhet të evidentohet qartë nëse kërkuesi përfshihet në kategorinë e subjekteve përfituese sipas aktit normativ.

2. Nëse nga të dhënat e përcjella nga administrata tatimore, nuk evidentohet qartë fakti i mësipërm, ose ka mungesa dhe paqartësi në dokumentacionin tjetër të përcjellë, struktura përgjegjëse i kërkon administratës tatimore saktësimin apo plotësimin e të dhënave që mund t'i shërbejnë vlerësimit të mëtejshëm të kërkesës.

3. Në rast se dokumentacioni i përcjellë nga administrata tatimore është i plotë ose është plotësuar më pas me dokumentacionin shtesë të përcjellë prej saj, struktura përgjegjëse vijon me shqyrtimin e kërkesës dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 4

Verifikimi nga Policia e Shtetit

1. Pas administrimit të dokumentacionit nga administrata tatimore dhe nëse rezulton se kërkuesi përfshihet në kategorinë e subjekteve përfituese, struktura përgjegjëse i kërkon zyrtarisht Policisë së Shtetit të verifikojë nëse, sipas informacionit dhe dokumentacionit të administruar prej saj, dëmi është shkaktuar gjatë periudhës nga data 13.10.2026 deri në datën 22.10.2026 dhe nëse dëmet materiale kanë ardhur nga aktet e dhunshme gjatë tubimeve. Gjithashtu, Policisë së Shtetit i kërkohet nëse ka të dhëna kontradiktore me provat e paraqitura nga kërkuesi, së bashku me të dhënat identifikuese për individë, persona juridikë apo organizata të tjera, shkaktues të këtyre dëmeve, si dhe, në rast të identifikimit të mëvonshëm të tyre, të përcjellë menjëherë informacionin përkatës.

2. Kërkesës për verifikim i bashkëlidhen të dhënat dhe dokumentet e nevojshme të disponuara që mund të ndihmojnë në identifikimin e subjektit, pasurisë, vendit dhe kohës së ngjarjes, si dhe provat përkatëse të administruara në dosje.

3. Nëse nga verifikimi i Policisë së Shtetit rezulton se dëmet e pësuara nuk kanë ardhur gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ose nuk kanë ardhur nga aktet e dhunshme gjatë tubimeve apo nuk ka prova të mjaftueshme për këtë fakt, struktura përgjegjëse vendos mopranimin e kërkesës dhe për këtë njofton, brenda 3 ditëve pune, kërkuesin.

4. Në rast se nga Policia e Shtetit konfirmohet se dëmi është shkaktuar gjatë tubimit të dhunshëm dhe nga veprimet e protestuesve dhe brenda periudhës 13–22 tetor 2026, struktura përgjegjëse vijon me shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës, për të cilën, brenda 30 ditëve nga përfundimi i evidentimit, duhet të vendoset kalimi ose jo i shumës së kompensimit në llogarinë bankare të kërkuesit.

Neni 5

Caktimi i ekspertit dhe vlerësimi i dëmit

1. Pas konfirmimit nga Policia e Shtetit, struktura përgjegjëse fillon procedurën për vlerësimin e dëmit.

2. Vlerësimi i dëmit kryhet nga ekspertë të licencuar, nga lista e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve që administrohet nga Ministria e Drejtësisë. Ekspertët caktohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh natyrën dhe llojin e pasurisë së dëmtuar.

3. Struktura përgjegjëse përgatit propozimin për caktimin e ekspertit, ku përcaktohen subjekti i dëmtuar, pasuria që do t’i nënshtrohet ekspertimit dhe objekti i ekspertimit.

4. Ekspertit të caktuar i vihet në dispozicion dokumentacioni i administruar gjatë shqyrtimit të kërkesës, përfshirë dokumentacionin e përcjellë nga administrata tatimore, në masën e nevojshme për kryerjen e ekspertimit.

5. Në aktin e caktimit të ekspertit përcaktohen detyrat dhe pyetjet konkrete, të cilave eksperti duhet t’u japë përgjigje të arsyetuar në aktin e ekspertimit, në përputhje me natyrën e pasurisë së dëmtuar dhe objektin e ekspertimit. Në çdo rast, ekspertit i kërkohet:

a) të identifikojë dhe të përshkruajë pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme që kanë pësuar dëmtime, duke përcaktuar karakteristikat e tyre, gjendjen fizike dhe, për aq sa mund të evidentohet, gjendjen përpara shkaktimit të dëmit;

b) të përcaktojë natyrën, llojin dhe shkallën e dëmtimeve të konstatuara për secilën pasuri, duke evidentuar në mënyrë të veçantë dëmtimet e pjesshme dhe ato të plota;

c) të vlerësojë, mbi bazën e dokumentacionit të administruar, këqyrjes në vend dhe të dhënave të tjera të disponueshme, nëse dëmtimet e konstatuara

përputhen, nga pikëpamja teknike, me mekanizmin dhe rrethanat e ngjarjes së përshkruar në dokumentacionin e përcjellë nga Policia e Shtetit;

ç) të përcaktojë nëse pasuria e dëmtuar mund të riparohet ose të rikthehet në gjendjen e mëparshme, duke identifikuar ndërhyrjet, punimet, materialet dhe shërbimet e nevojshme për këtë qëllim. Kjo i shërben përcaktimit të vlerës së nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e pasurisë së dëmtuar, sipas rastit, duke marrë në konsideratë çmimet e tregut, karakteristikat teknike, gjendjen dhe amortizimin e pasurisë përpara dëmtimit, si dhe dokumentacionin financiar dhe tatimor të administruar;

d) të përcaktojë vlerën e dëmit për secilën pasuri ose element të dëmtuar, përfshirë mallrat dhe gjendjen e inventarit të subjektit në momentin e shkaktimit të dëmit, duke u bazuar në faturat tatimore, dokumentacionin e inventarit të deklaruar dhe dokumentacionin tjetër financiar e kontabël të administruar, duke paraqitur në mënyrë të detajuar zërat përkatës të dëmit, sasitë, çmimet njësi dhe përllogaritjet mbi të cilat mbështetet vlerësimi;

dh) të përcaktojë vlerën totale përfundimtare të dëmit material, të shprehur në lekë, duke paraqitur metodën e përdorur për vlerësimin, burimet e të dhënave dhe arsyetimin teknik të përfundimeve të arritura.

6. Eksperti kryen vlerësimin e dëmit nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe, kur është e nevojshme, këqyrjes në vend të pasurisë së dëmtuar. Subjekti kërkues njoftohet për kryerjen e ekspertimit dhe mundëson aksesin në pasurinë e dëmtuar.

7. Eksperti, i caktohet një afat prej 10 ditësh nga data e caktimit, për të hartuar dhe dorëzuar pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit aktin e ekspertimit, në të cilin evidentohen pasuria e dëmtuar, natyra dhe përmasat e dëmit, si dhe vlera përfundimtare e tij, e shprehur në lekë.

8. Në raste të veçanta, kur për shkak të natyrës ose kompleksitetit të dëmit ekspertimi nuk mund të përfundojë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, afati mund të zgjatet me 5 ditë të tjera, me kërkesë të arsyetuar të ekspertit.

9. Struktura përgjegjëse administron aktin e ekspertimit dhe, në rast se konstaton paqartësi ose mangësi, i kërkon ekspertit sqarimin ose plotësimin e tij. Kur mangësitë nuk mund të korrigjohen në këtë mënyrë, mund të propozohet kryerja e riekspertimit nga një ekspert tjetër, sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

10. Vlera e dëmit, e përcaktuar në aktin e ekspertimit, shërben si bazë për përcaktimin e shumës së kompensimit, në përputhje me parashikimet e aktit normativ, duke zbritur, sipas rastit, vlerën e dëmit të mbuluar nga shoqëria e sigurimit.

11. Pas administrimit të aktit të ekspertimit, struktura përgjegjëse vijon me procedurën për pranimin e kërkesës dhe miratimin e shumës së kompensimit, sipas këtij udhëzimi.

12. Shpenzimet për kryerjen e aktit të ekspertimit përballohen nga fondi i alokuar për përballimin e shpenzimeve të kompensimit sipas pikës 10, të nenit 4, të aktit normativ nr. 6, datë 28.10.2026.

Neni 6

Trajtimi i pasurisë së siguruar

1. Struktura përgjegjëse verifikon deklarimin e kërkuesit për gjendjen e sigurimit dhe dokumentet e paraqitura sipas nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të aktit normativ.

2. Nëse deklarimi i kërkuesit apo dokumentacioni i administruar nuk përcaktojnë gjendjen e sigurimit, për qëllime të verifikimit të gjendjes së sigurimit të pasurisë së dëmtuar, i kërkohet informacion shoqërive të sigurimit, nëse pasuria është e siguruar, nëse kontrata e sigurimit mbulon rrezikun e dëmtimit nga trazirat, tubimet ose aktet e dhunshme, si dhe masën e mbulimit të dëmit nga sigurimi, kur është rasti.

3. Në rast se shoqëria e sigurimit ka kryer vlerësimin e dëmit dhe ka hartuar aktin përkatës të vlerësimit, ky akt merret për bazë nga struktura përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së dëmit, pa qenë e nevojshme kryerja e një ekspertimi tjetër.

4. Nëse pasuria është e pasiguruar, kompensimi llogaritet mbi vlerën e plotë të dëmit të përcaktuar në aktin e ekspertimit.

5. Nëse kontrata e sigurimit nuk mbulon rrezikun e dëmtimit nga trazirat, tubimet ose aktet e dhunshme, pasuria trajtohet si e pasiguruar për qëllimet e aktit normativ, mbi bazën e dokumenteve përkatëse të shoqërisë së sigurimit.

6. Kur shoqëria e sigurimit mbulon vetëm një pjesë të dëmit, kompensimi nga shteti përfshin vetëm pjesën e pambuluar, duke mos tejkaluar në total vlerën e dëmit të përcaktuar në aktin e ekspertimit.

7. Në rast se rezulton që pasuria e dëmtuar mbulohet plotësisht nga shoqëria e sigurimit, struktura përgjegjëse vendos mospranimin e kërkesës.

8. Veprimet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kryhen pa pritur konfirmimin e Policisë së Shtetit, lidhur me faktin e shkaktimit të dëmeve nga protestuesit gjatë tubimit të dhunshëm.

Neni 7

Përfundimi i shqyrtimit dhe vendimmarrja

1. Në përfundim të shqyrtimit, struktura përgjegjëse përgatit relacionin përmbledhës të praktikës, ku pasqyrohen të dhënat për subjektin, verifikimi i kushteve të përfitimit, përgjigjja e Policisë së Shtetit, akti i ekspertimit, gjendja e sigurimit dhe shuma e propozuar për kompensim.

2. Kur nga verifikimet e kryera rezulton se dëmi është shkaktuar gjatë tubimeve të dhunshme nga veprimet e protestuesve dhe janë përmbushur kushtet e tjera të përcaktuara në aktin normativ, struktura përgjegjëse merr vendim për pranimin e kërkesës dhe miratimin e shumës së kompensimit, bazuar në vlerën e dëmit të përcaktuar në aktin e ekspertimit, duke zbritur, sipas rastit, pjesën e dëmit të mbuluar nga shoqëria e sigurimit. Vendimi përmban të dhënat identifikuese të përfituesit, vlerën totale të dëmit, shumën e mbuluar nga sigurimi, shumën përfundimtare të kompensimit dhe të dhënat e llogarisë bankare të përfituesit.

3. Nëse nuk ka prova të mjaftueshme që dëmi është shkaktuar gjatë tubimit të dhunshëm nga protestuesit ose nuk plotësohen kushtet ligjore për përfitim, kërkesa nuk pranohet. Vendimi përkatës arsyetohet dhe i njoftohet kërkuesit.

Neni 8

Procedura e kryerjes së pagesës

1. Pas miratimit të kompensimit, struktura përgjegjëse përcjell te struktura e financës së ministrisë aktin e vendimmarrjes, të dhënat identifikuese të përfituesit, shumën e miratuar dhe numrin e llogarisë bankare të administruar në dosje.

2. Struktura financiare kryen verifikimet e nevojshme dhe vijon me kryerjen e pagesës në llogarinë bankare të subjektit përfitues, në përputhje me legjislacionin financiar dhe buxhetor në fuqi.

3. Pagesat përballohen nga buxheti i ministrisë, me fondet që alokohen me vendim të Këshillit të Ministrave, për këtë qëllim.

4. Dokumenti që vërteton realizimin e pagesës administrohet në dosjen e kërkesës. Ministria mban evidencë të pagesave të miratuara dhe të kryera, për të shmangur kompensimin e dyfishtë për të njëjtin dëm.

Neni 9

Përcjellja e të dhënave për ushtrimin e regresit

1. Pas kryerjes së pagesës së kompensimit, në rastet kur janë identifikuar subjektet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit, struktura përgjegjëse përgatit dhe përcjell pranë strukturës që merret me çështjet gjyqësore, praktikën e administruar dhe kjo e fundit i përcjell Avokaturës së Shtetit dokumentacionin përkatës, për ushtrimin e së drejtës së regresit, në përputhje me nenin 5 të aktit normativ.

2. Dokumentacioni që i përcillet Avokaturës së Shtetit, përfshin:

a) kërkesën për kompensim dhe dokumentacionin shoqërues;

b) informacionin e Policisë së Shtetit, lidhur me rrethanat e shkaktimit të dëmit dhe identifikimin e subjekteve përgjegjëse;

c) aktin e ekspertimit për përcaktimin e vlerës së dëmit;

ç) vendimin për miratimin e kompensimit;

d) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së kompensimit në favor të subjektit të dëmtuar;

dh) çdo dokument tjetër të administruar që lidhet me shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë e subjekteve të identifikuara.

3. Në rast se subjektet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit identifikohen pas kryerjes së pagesës së kompensimit, struktura përgjegjëse, menjëherë pas marrjes së informacionit nga Policia e Shtetit, ia përcjell atë strukturës që mbulon çështjet gjyqësore në ministri, e cila i përcjell Avokaturës së Shtetit dokumentacionin përkatës për ushtrimin e së drejtës së regresit.

4. Struktura përgjegjëse bashkëpunon me Avokaturën e Shtetit dhe i vë në dispozicion çdo informacion ose dokumentacion shtesë që kërkohet për ushtrimin e së drejtës së regresit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit

1. Struktura përgjegjëse mban dosjet dhe evidencat e kërkesave të administruara, vendimeve dhe pagesave dhe në përfundim të vendimmarrjes, i depoziton ato në sektorin e Arkiv-Protokollit të ministrisë, në përputhje me legjislacionin për arkivat dhe administrimin e dokumentacionit zyrtar.

2. Strukturat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit bashkërendojnë veprimet për zbatimin e këtij udhëzimi me administratën tatimore, Policinë e Shtetit dhe sipas rastit, institucionet e tjera kompetente.

Neni 11

Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen struktura përgjegjëse për nxitjen e biznesit dhe zhvillimin ekonomik, dhe strukturat e tjera sipas detyrave në këtë udhëzim, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Delina Ibrahimaj